



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 108/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt “*Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore*”, me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

**Ankimues:** “Rej” sh.p.k.  
Lagjja nr.3, Shëtitore “Europa”, Pogradec

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër  
Rruga "13 Dhjetori", Nr. 1, Shkodër

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Vepërtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.10.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt “*Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore*”, me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 13.10.2020, operatori ekonomik “Rej” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Operatori ekonomik ankimues sqaron se nuk ka marrë asnjë përgjigje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e paraqitur sipas tij në datën 13.10.2020 pranë këtij të fundit, ndërkohë që nga informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të

Prokurimit Publik, rezulton se ankesës i është kthyer përgjigje nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën me nr. 14413/1 prot., datë 19.10.2020.

II.4. Në datën 26.10.2020, operatori ekonomik ankimues ka depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e kriterëve të dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datë 09.12.2020 Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k., mori vendimin K.P.P. 565/2020, datë 09.12.2020, ku vendosi:

[...]

- 1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore”, me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
- 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit dhe të japë sqarimet përkatëse në përputhje me konstatimet e sipërcituara dhe njëkohësisht të publikojë edhe shtojcën përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.6. Me anë të shkresës nr. 307 prot., datë 08.01.2021, protokolluar me tonën nr. 565/4 prot., datë 13.01.2021, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, njofton se ka zbatuar vendimin K.P.P. 565/2020, datë 09.12.2020, të Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P.565/2020, datë 09.12.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik. Rrjedhimisht, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit K.P.P.565/5/2021, datë 14.01.2021, vendosi:

- 1. Të heqë pezullimin për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore”, me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
- 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.7. Nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimi Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor në datë 07.01.2021 ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P.565/2020, datë 09.12.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.7.1. Në datën 11.01.2021, operatori ekonomik “Rej” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e shtojcës së publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë:

[...]

*Bazuar në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM-së nr 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, paraqesim ankesën si më poshtë:*

*Nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar në sistemin e prokurimit elektronik procedura e prokurimit me objekt "Shërbim i Pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore" me datë përfundimtare për dorëzimin e ofertave datën 30.10.2020.*

*Fillimisht kemi paraqitur ankim pranë Ak-së lidhur me kriteret e vendosura nga AK në DST e më pas kemi ezauruar ankimin administrativ pranë KPP-së.*

*KPP me anë të vendimit NR. 565/2020 ka vendosur:*

*1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Rej" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt "Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore", me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 30.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*

*2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit dhe të japë sqarimet përkatëse në përputhje me konstatimet e sipërcituara dhe njëkohësisht të publikojë edhe shtojcën përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi [...].*

*Nga ana e AK-së në datën 7.01.2021 është hedhur në sistem shtojca mbi modifikimin e kriterëve. Duke mos qenë dakord me disa prej kërkesave të autoritetit kontraktor lidhur me këtë procedurë prokurimi të pasqyruara në Shtojcë i kundërshtojmë ato përsa më poshtë vijon:*

*Lidhur me:*

*V.O. Kjo procedurë prokurimi është shpallur me kushtin nëse Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ku ndodhet kjo çështje për gjykim, shprehet me një vendim të formës së prerë që bie ndesh me këtë procedurë prokurimi/kontrate, kjo procedurë prokurimi/kontrate do të ndërpritet dhe zgjidhet.*

*Çmohet se ky parashikim është i paqartë. Nëse ka një çështje për gjykim dhe nga rezultati i këtij të fundit varet dhe ecuria e kësaj kontrate atëherë autoriteti kontraktor duhet të parashikojë ndërprerjen dhe zgjidhjen e kontratës por duke sqaruar efektet e zgjidhjes së kontratës si janë afatet e përfundimit të saj, lirimi i sigurimit të kontratës si do të kryhet etj.*

*Lidhur me:*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasitë përkatëse për mjetet si më poshtë:*

- a) *Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 5 (pesë) copë.*
- b) *Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo me shume se 5ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;*
- c) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;*
- d) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 6-8 m3, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të plhurave (aspirator) dhe sistem spërkatjeje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se 1 (një) copë;*
- e) *Makina teknologjike për fshirjen e trotuareve dhe pedonale, me kapacitet mbajtës 0,25 m3, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) me gjerësi jo me pak se 85 cm, jo më pak se 1 (një) copë;*
- f) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 8000 litra ujë, jo më pak se 1 (një) copë;*
- g) *Mjete teknologjike pastrimi rezervë jo më shumë se 5ton ose jo më pak se 10 ton, jo më pak se 1 (një) copë i vitit të prodhimit, jo më poshtë se 2005.*

*1.Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 10, gërma a – g, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- a) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin e prokurimit dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- b) *Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- c) *Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- d) *Mjetet e porositura/shitura me kusht/me huapërdorje apo çdo formë posedimi që njeh legjislacioni shqiptar duhet të shoqërohen me dokumente si Akt Marrëveshjen e porosisë/ Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar)/ kontratën e huapërdorjes/ kontratën e shitjes me kusht/etj. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontratën e Porosisë/kontratën e huapërdorjes/ kontratën e shitjes me kusht/ etj duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin (emërtimin teknik), llojin, markën, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë/shitjes me kusht/huapërdorjes etj..*
- e) *Për mjetet e paregjistruara në Republikën e Shqipërisë, paraqitet marrëveshje paraprake e shitblerjes sipas njërit prej rasteve në vijim,*
  - (i) me pronarin e automjeteve,*

(ii) me koncesionarin ose ndërmjetësin në rastin kur ka periudhë tranzitore për të pasur të drejtën e posedimit të mjeteve,

(iii) me prodhuesin ose koncesionarin në rastin e paraqitjes në procedurën e prokurimit me mjete të reja.

Në të gjitha rastet subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm i cili vërteton se subjekti që merr përsipër furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit të vendit të origjinës, të drejtën për të pasur në pronësi ose gëzon të drejtën e shitblerjes së mjeteve të paraqitura.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

g) Për mjetet në pronësi/qira/të porositura/huapërdorje apo çdo formë që njeh legjislacioni shqiptar, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

Paraprakisht sqarohet se lidhur me:

a) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 6 – 8 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshese qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se 1 (një) copë;

b) Makina teknologjike për fshirjen e trotuareve dhe pedonale, me kapacitet mbajtës 0,25 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) me gjerësi jo më pak se 85 cm, jo më pak se 1 (një) copë;

Pra është e paqartë për ne pasi me mjetet e mësipërme, me dokumentacionin e kërkuar nga AK nuk provohet dot disponueshmëria e tyre.

Së dyti, kërkesa lidhur me:

a) Për mjetet në pronësi/qira/të porositura/huapërdorje apo çdo formë që njeh legjislacioni shqiptar, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

Bazuar dhe në ligjin 9643 "Për Prokurimin Publik" Indryshuar dhe VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar nuk parashikohet mundësia e kalimit nga ofertuesi i dytë tek ai i parë pas shpalljes së njoftimit të fituesit. Në kushtet kur ky përcaktim nuk gjen mbështetje ligjore duhet ndryshuar.

Lidhur me datën e zhvillimit të procedurës, në shtojcën e përcaktuar nga AK është parashikuar se:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 19/01/2021 Ora: 10:00.

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

*Afati I mësipërm bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi.*

II.7.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, në datën 14.01.2021, me anë të shkresës nr.450/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka argumentuar:

*Në lidhje me ankesën tuaj protokolluar në tonën me nr. 450 prot, datë 11.01.2021 drejtuar Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër me të cilën kundërshtoni kriteret e vendosura për kualifikim për procedurën e prokurimit me objekt: "Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore" ju informojmë si më poshtë:*

*Me marrjen e ankesës procedura e prokurimit është pezulluar dhe shqyrtimi i saj i është ngarkuar Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.*

*Pasi u njoha me relacionin dhe vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës ju parashtrojmë sqarimet si më poshtë:*

*Në zbatim të Vendimit Nr.565/3/2020 Prot datë 30.12.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik protokolluar pranë Bashkisë Shkodër me nr.20 prot datë 05.01.2021, Bashkia Shkodër me datë 07.01.2021 ka hartuar dhe publikuar në SPE shtojcën mbi ndryshimet e DST në zbatim të rekomandimeve të këtij vendimi.*

*Me shkresën nr.307 prot datë 08.01.2021 Bashkia Shkodër i ka dërguar informacion KPP mbi masat e marra në zbatimin e vendimit Nr.565/3/2020 Prot datë 30.12.2020. Jemi në pritje të konfirmimit nga ana e KPP, nëse shtojca mbi modifikimin e kriterëve të DST e publikuar në SPE nga Bashkia Shkodër është apo jo në përputhje me vendimin nr.Nr.565/3/2020 Prot datë 30.12.2020 si dhe për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*

II.7.3. Në datën 18.01.2021 operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]

*Nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar në sistemin e prokurimit elektronik procedura e prokurimit me objekt "Shërbim i Pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore" me datë përfundimtare për dorëzimin e ofertave datën 30.10.2020.*

*Fillimisht OE ankimues ka paraqitur ankim administrativ pranë AK-së lidhur me kriteret e vendosura nga AK ne DST e më pas kemi ezauruar ankimin administrativ pranë KPP-së.*

*KPP me anë të vendimit Nr. 565/2020 ka vendosur:*

*1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Rej" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt "Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore", me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 30.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*

*2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit dhe të japë sqarimet përkatëse në përputhje me konstatimet e sipërcituara dhe njëkohësisht të publikojë edhe shtojcën përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

*3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*

4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Rej" sh.p.k.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

*Nga ana e Ak-së me datë 07.01.2021 është publikuar në SPE Shtojca mbi modifikimin e kritereve. Duke i gjetur ndryshimet të paqarta dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, fillimisht ezauruam ankimin administrativ pranë AK-së nëpërmjet ankesës protokolluar pranë AK-së datë 11.01.2021 numër protokolli 450.*

*AK, nëpërmjet komunikimit elektronik (email) me datë 14.01.2021 bëri me dije Oe ankimues për refuzimin e ankesës, nëpërmjet shkresës bashkëlidhur Nr. 450/l prot. datë\ 14.01.2021.*

*Sa më sipër, duke vlerësuar se veprimet e AK-së vijnë në kundërshtim me dispozitat ligjore paraqesim këtë ankesë përsa më poshtë vijon.*

*Së pari, lidhur me datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.*

*Në SPE dhe në shtojcën e ngarkuar nga AK është parashikuar data 19.01.2021 për zhvillimin e procedurës së prokurimit.*

*Në datën 07.01.2021 është publikuar në SPE shtojca me ndryshimet përkatëse dhe me afat për zhvillimin e procedurës në datën 19.01.2021 ora vetëm 12 ditë pas datës së publikimit.*

*Në nenin 63 të LPP-së parashikohet se:*

*1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

*1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.*

*2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*

*3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.*

*4. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore të procedurës së prokurimit për periudhën e pezullimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni. Në rast se afatet kohore të procedurës së prokurimit, të njoftuara për ofertuesit, ndryshojnë për shkak të shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit për arsyet e zgjatjes së afatit kohor.*

*5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.*



6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.

7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkëlqes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallet e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.

8. Me marrjen e ankesës së ankimuesit për në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor mban të pezulluar procedurën e prokurimit, me përjashtim të rasteve kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos ndryshe, në përputhje me pikën 2, të nenit 64, të këtij ligji. Autoriteti kontraktor ia dërgon të gjithë informacionin që disponon për procedurën e prokurimit të ankimit menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë, Komisionit të Prokurimit Publik."

9. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës. Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar.

Përjashtimisht, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, për shkaqe të ligjshme, nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit 15 ditor, duhet t'i bëjë të ditur palëve në proces, arsyet e mosmarrjes së këtij vendimi. Nga ky moment, brenda 15 ditëve, Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të dalë me vendimin përfundimtar për shqyrtimin e ankesës.

10. Çdo ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

11. Për procedurat e prokurimit, për të cilat nuk bëhet njoftim publik, sipas nenit 38 të këtij ligji, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e ankimit administrativ."

Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar afatet për mundësinë procedurale të OE pjesëmarrës të mundshëm, për paraqitjen e ankesave në AK dhe më pas në KPP brenda afateve ligjore.

Duke mos i dhënë mundësinë procedurale OE për të paraqitur ankesë në afatet e parashikuara nga ligji përben shkak për diskriminim dhe paligjshmëri të veprimtarisë së AK-së.

Në interpretim të pikës 4 të nenit 63 vërehet se ligjvënësi ka parashikuar një zgjatje të afatit të barabartë me pezullimin e procedurës së prokurimit, afat i cili deri në daljen e vendimit të KPP-së nr. 565/2020.

Pra koha e pezullimit ka rezultuar të jetë më e gjatë se koha e shtyrjes së zhvillimit të procedurës, e për më tepër koha e vënë në dispozicion, bie ndesh me dispozitat ligjore për ezaurimin e ankimeve lidhur me kriteret e ndryshuara nga AK.

Së dyti, lidhur me ndryshimin:

V.O. Kjo procedure prokurimi është shpallur me kushtin nëse Gjykata Administrative e Apelit Tirane, ku ndodhet kjo çështje për gjykim, shprehet me një vendim të formës së prerë që bie ndesh me këtë procedure prokurimi/kontrate, kjo procedurë prokurimi/kontrate do të ndërpritet dhe zgjidhet.

Ndryshimi i bërë nga AK është serish i paqartë. Nëse ka një çështje për gjykim dhe nga rezultati i këtij të fundit varet ecuria e kësaj kontrate atëherë autoriteti kontraktor duhet të parashikojë zgjidhjen e kësaj kontrate por duke sqaruar efektet e zgjidhjes së saj siç janë afatet e përfundimit të saj, kushtet për lirim të sigurimit të kontratës dhe nëse do të gjendemi përpara një zgjidhjeje të menjëhershme të kontratës apo do ti lihet në dispozicion një kohe e caktuar deri në zgjidhjen OE të mundshëm fitues. Pra sqarimi i këtyre fakteve është tepër i rëndësishëm pasi angazhimi që kërkohet nga AK për realizimin e kësaj kontrate është tepër i madh dhe një zgjidhje e menjëhershme e kontratës do të ekspozonte OE pjesëmarrës për dëme të mundshme financiare.

Së treti, lidhur me ndryshimin:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasinë përkatëse për mjetet si më poshtë:

- h) Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 5 (pesë) copë.
- i) Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 5ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;
- j) Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundur ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;
- k) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 6-8 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se 1 (një) copë;
- l) Makina teknologjike për fshirjen e trotuareve dhe pedonale, me kapacitet mbajtës 0,25 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) me gjerësi jo më pak se 85 cm, jo më pak se 1 (një) copë;
- m) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 8000 litra ujë, jo më pak se 1 (një) copë;
- n) Mjete teknologjike pastrimi rezervë jo më shumë se 5ton ose jo më pak se 10 ton, jo më pak se 1 (një) copë i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005.

1.Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 10, gërma a – g, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- h) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale të qirasë. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin e prokurimit dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).

- i) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- j) Për mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- k) Mjetet e porositura/ shitura me kusht/ me huapërdorje apo çdo formë posedimi që njeh legjislacioni shqiptar duhet të shoqërohen me dokumente si Akt Marrëveshjen e porosisë/ Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar)/ kontratën e huapërdorjes/ kontratën e shitjes me kusht/etj. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë/kontratën e huapërdorjes/ kontratën e shitjes me kusht/ etj duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin (emërtimin teknik), llojin, markën, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë/shitjes me kusht/huapërdorjes etj..
- l) Për mjetet e paregjistruara në Republikën e Shqipërisë, paraqitet marrëveshje paraprake e shitblerjes sipas njërës prej rasteve në vijim,
  - (i) me pronarin e automjeteve,
  - (ii) me koncesionarin ose ndërmjetësin në rastin kur ka periudhe tranzitore për të pasur të drejtën e posedimit të mjeteve,
  - (iii) me prodhuesin ose koncesionarin në rastin e paraqitjes në procedurën e prokurimit me mjete të reja.

Në të gjitha rastet subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm i cili vërteton se subjekti që merr përsipër furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit të vendit të origjinës, të drejtën për të pasur në pronësi ose gëzon të drejtën e shitblerjes së mjeteve të paraqitura.
- m) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- n) Për mjetet në pronësi/qera/të porositura/huapërdorje apo çdo formë që njeh legjislacioni shqiptar, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qellim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

Paraprakisht bëjmë me dije se lidhur me mjetet teknologjike për fshirjen e rrugëve dhe ato të trotuareve kemi kërkuar sqarim sesi mund të provohet disponimi i tyre pasi karakteristikat e mjetit si p.sh. sistemi thithës i pluhurave për mjetet për fshirjen e rrugëve dhe gjerësia e fshesës anësore për mjetet për fshirjen e trotuareve jo me pak se 85 cm janë specifikime të cilat nuk provohen dot nga asnjë prej dokumenteve të paraqitura nga OE ankimes. Si rrjedhojë do të kishim një paqartësi si për OE dhe për vetë KVO në vlerësimin e ofertave.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e

*prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jo diskriminuese."*

*Ndërsa në nenin 28/2 të VKM 914/2014 i ndryshuar përcaktohet se: "2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."*

*Sa më sipër, kriteri lidhur me disponimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës nuk është hartuar në mënyrë të qartë duke lënë vend për konfuzion dhe evazivitet gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.*

*Së katërti lidhur me parashikimin e Ak-së se:*

*Për mjetet në pronësi/qira/të porositura/huapërdorje apo çdo formë që njih legjislacioni shqiptar, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.*

*Gjykojmë se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e veçante të vendosur. Por këto kritere dhe parashikime në DST duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Parashikimi IAK pas shpalljes së fituesit, çmojmë se nuk gjen asnjë pikë takimi me LPP dhe VKM nr. 914 date 29.12.2014 pasi në asnjë rast nuk parashikohet mundësia e skualifikimit të subjektit të shpallur fitues dhe kalimi tek ofertuesi i renditur i dyti lidhur me verifikimin përsa më sipër është parashikuar në Shtojcën.*

II.5. Në datën 03.02.2021, nëpërmjet shkresës nr. 1509/1 Prot., datë 29.01.2021, me objekt "Informacion", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” sh.p.k. se, [...] së pari, lidhur me datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Në SPE dhe në shtojcën e ngarkuar nga AK është parashikuar data 19.01.2021 për zhvillimin e procedurës së prokurimit. Me datën 07.01.2021 është publikuar në SPE shtojca me ndryshimet përkatëse dhe me afat për zhvillimin e procedurës datën 19.01.2021 pra vetëm 12 dite pas datës së publikimit, [...] Sa me sipër, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar afatet për mundësinë procedurale të OE pjesëmarrës të mundshëm, për paraqitjen e ankesave në AK dhe më pas në KPP brenda afateve ligjore.

Duke mos i dhënë mundësinë procedurale OE për të paraqitur ankesë në afatet e parashikuara nga ligji përben shkak për diskriminim dhe paligjshmëri të veprimtarisë së AK-se.

Në interpretim të pikës 4 të nenit 63 vërehet së ligjvënësi ka parashikuar një zgjatje të afatit të barabartë me pezullimin e procedurës së prokurimit, afat i cili deri në daljen e vendimit të KPP-së nr. 565/2020.

Pra koha e pezullimit ka rezultuar të jetë më e gjatë se koha e shtyrjes së zhvillimit të procedurës, e për më tepër koha e vënë në dispozicion, bie ndesh me dispozitat ligjore për ezaurimin e ankimeve lidhur me kriteret e ndryshuara nga AK.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor në datë 07.01.2021 “Shtojcë mbi Modifikimin dhe ndryshimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.565/2020 Prot datë 09.12.2020 , Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 (pesë) ditë kalendarike.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore”, është si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 19/01/2021 Ora: 10:00.

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 19/01/2020 Ora: 10:00.

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

III.1.2. Në nenin 42, pika 2, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“2. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u

*komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.*

*2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”*

III.1.3. Në nenin 78, pika 6/d, të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar parashikohet se:

*“d) Autoriteti kontraktor, nëse nevojitet, duhet të zgjasë afatin kohor të procedurës së prokurimit aq sa zgjat periudha e pezullimit. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasyshe të ankesës, autoriteti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.”*

III.1.4. Në rekomandimin Nr.1474 Prot datë 11.11.2020; Nr.7267 prot., datë 11.11.2020 “Rekomandim mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik në rastet e ankesave për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit”, midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, është sqaruar:

[...]

*Në rast se, KPP konstaton se:*

- a) autoritetet kontraktore kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP me vendim të arsyetuar vendos heqjen e pezullimit. Pasi vihet në dijeni të këtij vendimi, autoriteti kontraktor duhet të shtyjë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 42, pika 2/1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe më pas të nxjerrë procedurën nga pezullimi.*
- b) autoritetet kontraktore nuk kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP vendos për lënien në fuqi të masës së pezullimit. Në këtë rast, autoriteti kontraktor duhet të zbatojë menjëherë vendimin, si dhe të publikojë shtojcën mbi ndryshimin e dokumenteve në SPE dhe të njoftojë KPP.*

*Në çdo rast, me qëllim trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë, bazuar në parimin e transparencës, si edhe duke qenë se vendimi i KPP konsiderohet i zbatuar vetëm në momentin e heqjes së pezullimit, autoritetet kontraktore rekomandohen të shtyjnë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 42, pika 2/1, të ligjit or. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, vetëm pas marrjes në dijeni të vendimit për heqjen e pezullimit nga ana e KPP-se.*

III.1.5. Nga interpretimi literal i dispozitave të mësipërme, Komisioni gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar qartësisht se autoritetet kontraktore në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce, me detyrimin e vetëm që kjo shtojcë t'i komunikohet të gjithë operatorëve ekonomik, si dhe afati përfundimtar për pranimin e ofertave të shtyhet me 5 ditë. Komisioni vlerëson të theksojë se, në ligjin për prokurimin publik dhe në rregullat e prokurimit publik, janë parashikuar dy përcaktime lidhur me zgjatjen e afatit kohor të dorëzimit të ofertave. Në rastin e modifikimit të dokumenteve të tenderit, ligjvënësi ka sanksionuar në mënyrë eksplicite se, në çdo rast afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave shtyhet me 5 ditë, ndërsa nga ana tjetër, në rregullat e

prokurimit publik, parashikohet në mënyrë kushtore se, “nëse nevojitet” autoriteti kontraktor mund të shtyjë afatin e procedurës së prokurimit për aq kohë sa zgjat periudha e pezullimit.

Nga verifikimi i kryer, rezulton se autoriteti kontraktor në datën 07.01.2021, ka ngarkuar në SPE një shtojcë mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik K.P.P. 565/2020, datë 09.12.2020, procedurë e cila ishte parashikuar të zhvillohej në datën 30.10.2020. Gjithashtu, konstatohet se autoriteti kontraktor ka shtyrë afatin për pranimin e ofertave nga data 30.10.2020, në datën 19.01.2021, pasi në datë 09.12.2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë vendimin nr.565/2020 në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit dhe pas zbatimit të këtij vendimi nga ana e autoritetit kontraktor, në datë 14.01.2021 Komisioni i Prokurimit Publik, ka vendosur të heqë nga pezullimi procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, ka shtyrë afatin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe të pranimit të ofertave, në përputhje të plotë me ligjin dhe rregullat për prokurimin publik. Në këto kushte, Komisioni gjykon se veprimet procedurale të kryera nga autoriteti kontraktor, lidhur me ndryshimin e dokumenteve të tenderit, janë tërësisht në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, pasi veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuar në nenin 42, pika 2, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Së dyti, lidhur me ndryshimin: V.O. Kjo procedurë prokurimi është shpallur me kushtin nëse Gjykata Administrative e Apelit Tirane, ku ndodhet kjo çështje për gjykim, shprehet me një vendim të formës së prerë që bie ndesh me këtë procedurë prokurimi/ kontrate, kjo procedurë prokurimi/ kontrate do të ndërpritet dhe zgjidhet. Ndryshimi i bere nga AK është sërish i paqartë. Nëse ka një çështje për gjykim dhe nga rezultati i këtij te fundit varet ecuria e kësaj kontrate atëherë autoriteti kontraktore duhet të parashikojë zgjidhjen e kësaj kontrate, por duke sqaruar efektet e zgjidhjes së saj siç janë afatet e përfundimit të saj, kushtet për lirimin e sigurimit të kontratës dhe nëse do të gjendemi përpara një zgjidhjeje të menjëhershme të kontratës apo do ti lihet në dispozicion një kohë e caktuar deri në zgjidhjen OE të mundshëm fitues. Pra sqarimi i këtyre fakteve është tepër i rëndësishëm pasi angazhimi që kërkohet nga AK për realizimin e kësaj kontrate është tepër i madh dhe një zgjidhje e menjëhershme e kontratës do të ekspozonte OE pjesëmarrës për dëme të mundshme financiare, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në datën 09.12.2020 Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k., mori vendimin K.P.P. 565/2020 datë 09.12.2020, ku vendosi:

[...]

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore”, me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit dhe të japë sqarimet përkatëse në përputhje me konstatimet e si më sipër cituar dhe njëkohësisht të publikojë edhe shtojcën përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.2.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor në datë 07.01.2021 “Shtojcë mbi Modifikimin dhe ndryshimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

ISHTE

V.O. Kjo procedurë prokurimi është shpallur me kushtin nëse Gjykata Administrative e Apelit Tirane, ku ndodhet kjo çështje për gjykim, shprehet me një vendim të formës së prerë, kjo procedurë prokurimi do të pezullohet në varësi të këtij vendimi.

BEHET

V.O. Kjo procedurë prokurimi është shpallur me kushtin nëse Gjykata Administrative e Apelit Tirane, ku ndodhet kjo çështje për gjykim, shprehet me një vendim të formës së prerë, që bie ndesh me këtë procedurë prokurimi/kontrate, kjo procedurë prokurimi/kontrate do të ndërpritet dhe zgjidhet .

III.2.3. Me anë të shkresës nr. 307 prot., datë 08.01.2021, protokolluar me tonën nr. 565/4 prot., datë 13.01.2021, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, njofton se ka zbatuar vendimin K.P.P. 565/2020, datë 09.12.2020, të Komisionit të Prokurimit Publik.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 63, pika 1 dhe 1.1, të ligjit nr. 9643, datë.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

“ 1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi



*mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.2.5. Nga interpretimi në tërësi i dispozitës së sipërcituar del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i pretendimit të mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Rej” sh.p.k., konstatohet se ky i fundit ngre përsëri pretendime në lidhje me modifikimin e kriterit, modifikimi i të cilit ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik K.P.P. 565/2020 datë 09.12.2020.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret pretendimi i mësipërm i parashtruar në ankesë nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k. përbën “*gjë të gjykuar*”, për të cilat Komisioni është shprehur në vendimin K.P.P 565/2020 datë 09.12.2020 mbi bazën e ankesës së paraqitur prej tij, për procedurën në fjalë, vendim i cili në bazë të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, përkatësisht nenit 19/1, është administrativisht përfundimtar. Në këtë kuptim, kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, *ipso lege*, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim.

III.2.7. KPP thekson faktin se fuqia e “*res judicata*” (*gjësë së gjykuar*) mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ përfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij.

Autoriteti kontraktor në publikimin e shtojcës për modifikimin e dokumenteve të tenderit të datës 07.01.2021, ka zbatuar Vendimin K.P.P. 565/2020 datë 09.12.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me pretendimet e mësipërme. Në këtë kuptim, Komisioni nuk gjendet përballë asnjë rrethane të re për të cilën nuk ka qenë në dijeni në kohën e marrjes së vendimit përfundimtar që të mund të legjitimojë ankimuesin “Rej” sh.p.k. në pretendimet e tij, për modifikimin përsëri të këtij kriteri.

III.2.8. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 19/1 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare*”, si dhe nenit 64, pika 2, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoritetet kontraktore duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dijeni për vendimin*”, gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. në thelb përbën rishikim të vendimit K.P.P. 565/2020 datë 09.12.2020, të cilin ligji ia njeh si të drejtë vetëm autoritetit kontraktor.

Sa më sipër arsyetuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Rej" sh.p.k. përsa i përket "Shtojcë mbi Modifikimin dhe ndryshimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit" të publikuar në datë 07.01.2021 nga autoriteti kontraktor, [...] *Paraprakisht bëjmë me dije se lidhur me mjetet teknologjike për fshirjen e rrugëve dhe ato të trotuareve kemi kërkuar sqarim sesi mund të provohet disponimi i tyre pasi karakteristikat e mjetit si p.sh. sistemi thithës i pluhurave për mjetet për fshirjen e rrugëve dhe gjerësia e fshesës anësore për mjetet për fshirjen e trotuareve jo me pak se 85 cm janë specifikime të cilat nuk provohen dot nga asnjë prej dokumenteve të paraqitur nga OE ankimues. Si rrjedhojë do të kishim një paqartësi si për OE dhe për vetë KVO në vlerësimin e ofertave.*

*Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, përsa kohe që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jo diskriminuese."*

*Ndërsa në nenin 28/2 të VKM 914/2014 i ndryshuar përcaktohet se: "2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatoret ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."*

*Sa me sipër, kriteri lidhur me disponimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës nuk është hartuar në mënyrë të qartë duke lënë vend për konfuzion dhe evazivitet gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.*

[...]

*Së katërti lidhur me parashikimin e Ak-së se:*

*Për mjetet në pronësi/qira/të porositura/huapërdorje apo çdo formë që njeh legjislacioni shqiptar, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qellim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.*

*Gjykojmë se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lenë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriterin e veçante të vendosur. Por këto kriterë dhe parashikime në DST duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Parashikimi IAK pas shpalljes së fituesit çmojmë se nuk gjen asnjë pike takimi me LPP dhe VKM nr. 914 date 29.12.2014 pasi në asnjë rast nuk parashikohet mundësia e skualifikimit të subjektit të shpallur fitues dhe kalimi tek ofertuesi i renditur i dyti lidhur me verifikimin përsa më sipër është parashikuar në Shtojcën [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor në datë 07.01.2021 “Shtojcë mbi Modifikimin dhe ndryshimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

1. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3.8 ‘Kapaciteti teknik’”

ISHTE

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasitë përkatëse për mjetet si më poshtë:

- a) *Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 5 (pesë) copë.*
- b) *Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 5ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;*
- c) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;*
- d) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 6-8 m3, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se 1 (një) copë;*
- e) *Makina teknologjike për fshirjen e trotuareve dhe pedonales, me kapacitet mbajtës 0,25 m3, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) me gjerësi jo më pak se 85 cm, jo më pak se 1 (një) copë;*
- f) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 8000 litra ujë, jo më pak se 1 (një) copë;*
- g) *Mjet teknologjike pastrimi rezervë jo me shuma se 5ton ose jo me pak se 10 ton jo më pak se 1 (një) copë i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005.*

1. Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 10, gërma a – g, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë. Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin e prokurimit dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- b) *Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- c) *Për mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- d) *Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin(emërtimin teknik), llojin,*

markën, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.

- e) Për mjetet e paregjistruara në Republikën e Shqipërisë, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerjeje sipas njërit prej rasteve në vijim,
- (i) me pronarin e automjeteve,
  - (ii) me koncesionarin ose ndërmjetësin në rastin kur ka periudhë tranzitore për të pasur të drejtën e posedimit të mjeteve,
  - (iii) me prodhuesin ose koncesionarin në rastin e paraqitjes në procedurën e prokurimit me mjete të reja.
- Në të gjitha rastet subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm i cili vërteton se subjekti që merr përsipër furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit të vendit të origjinës, të drejtën për të pasur në pronësi ose gëzon të drejtën e shitblerjes së mjeteve të paraqitura.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- g) Për mjetet në pronësi/qira apo të porositura, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të skualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

#### BEHET

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasitë përkatëse për mjetet si më poshtë:

- o) Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 5 (pesë) copë.
- p) Makinë teknologjike transportuese, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 5ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;
- q) Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundur ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005, jo më pak se 1 (një) copë;
- r) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 6-8 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatjeje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se 1 (një) copë;
- s) Makina teknologjike për fshirjen e trotuareve dhe pedonale, me kapacitet mbajtës 0,25 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) me gjerësi jo më pak se 85 cm, jo më pak se 1 (një) copë;

- t) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 8000 litra ujë, jo më pak se 1 (një) copë;*
- u) *Mjete teknologjike pastrimi rezervë jo më shumë se 5ton ose jo më pak se 10 ton, jo më pak se 1 (një) copë i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2005.*
- a) *Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 10, gërma a – g, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*
- o) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale të qirasë. Kontrata e qirasë duhet të përmbajë objektin e prokurimit dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
- p) *Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- q) *Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- r) *Mjetet e porositura/shitura me kusht/me huapërdorje apo çdo formë posedimi që njeh legjislacioni shqiptar duhet të shoqërohen me dokumente si Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar)/kontratën e huapërdorjes/kontratën e shitjes me kusht/etj. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë/kontratën e huapërdorjes/kontratën e shitjes me kusht/etj duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin(emërtimin teknik), llojin, markën, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë/shitjes me kusht/huapërdorjes etj..*
- s) *Për mjetet e paregjistruara në Republikën e Shqipërisë, paraqitet marrëveshje paraprake e shitblerjes sipas njërit prej rasteve në vijim,*  
*(i)me pronarin e automjeteve,*  
*(ii)me koncesionarin ose ndermjetësin në rastin kur ka periudhë tranzitore për të pasur të drejtën e posedimit të mjeteve,*  
*(iii)me prodhuesin ose koncesionarin në rastin e paraqitjes në procedurën e prokurimit me mjete të reja.*  
*Në të gjitha rastet subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm i cili vërteton se subjekti që merr përsipër furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit të vendit të origjinës, të drejtën për të pasur në pronësi ose gëzon të drejtën e shitblerjes së mjeteve të paraqitura.*
- t) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- u) *Për mjetet në pronësi/qira/të porositura/huapërdorje apo çdo formë që njeh legjislacioni shqiptar, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin*

*fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.*

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar: “1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se LPP parashikon në mënyrë eksplicite se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, fillimisht operatorët ekonomike që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e ankimit pranë autoritetit kontraktor brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjithë elementët formal sipas dispozitave ligjore. Operatori ekonomik ankimesi është njohur me kriteret e mësipërme për të cilat ka ngritur pretendime, që në publikimin e dokumenteve të tenderit, në datë 07.10.2020, dhe nuk ka ngritur pretendime në lidhje me to, si në ankesën e parë të paraqitur pranë autoritetit kontraktor në datë 13.10.2020, edhe në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në datë 26.10.2020. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimesi “Rej” sh.p.k, nuk i ka ezauruar shkallët e ankimit në përputhje me parashikimet e nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në lidhje me modifikimin e kriterëve të mësipërme, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Për këto arsye, KPP nuk mund të shqyrtojë pretendimet e operatorit ekonomik ankimesi për modifikimin e kriterëve të mësipërme për sa kohë që, ky ankim nuk është ezauruar, duke plotësuar kushtet formale, që në ankesën e parë të paraqitur pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k., fakt për të cilin ky i fundit ishte në dijeni që në publikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit, në datë 07.10.2020.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimesi nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-74121-10-06-2020, me objekt “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore”, me fond limit 119.309.800 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 90 Protokoli,**

**Datë 18.01.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**